

## NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

**Titulli :** Konsultim publik për Paketen Fiskale 2023 .

**Propozuesi i projektit:** Kryetari i Bashkisë.

**Qëllimi:** Ky bashkëbisedim me banorët dhe grupet e synuara te Bashkisë Shijak ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me Paketen Fiskale 2023-2025.

**Kalendari i konsultimit:** Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Xhafzotaj, në datë **16/12/2022, ora 17:00**.

Gjithashtu, sugjerimet e tyre janë të mirëpritura deri më datë 20 Nëntor 2022, në adresat e emaileve:

[kozetadoda@yahoo.com](mailto:kozetadoda@yahoo.com) [fabianakeci@gmail.com](mailto:fabianakeci@gmail.com)

**Pjesëmarrës:**

- **Nga ana e Bashkisë:** Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Kryetar i Bashkisë, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, drejtues/punonjës të administratës, drejtoria e buxhetit dhe financës, sektori i tativit taksave, Kryetarët e Fshatrave dhe Administratorët e Njësive Administrative.
- **Nga komuniteti:** Banorët e Bashkisë Shijak, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, gjimnazet, mësuesit dhe përfaqësues të komunitetit musliman në Shijak.

**Forma e konsultimit:** Takim në terren.

|  |   |
|--|---|
| Qëllimi i këshillimit publik   | Konsultimi publik në térren synon konsultimin e projekt aktit "Per Paketen Fiskale 2023 ";  |
| Përshkrimi i çështjes.   | Ky kapitull trajton taksat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:<br>- <u>Lloji, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkatgorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimore.</u>  |
| Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve; | Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit të sekretarisë së Këshillit Bashkiak dhe Koordinatorit për Konsultimin me Publikun, <b>BRENDA DATËS 15 dhjetor 2022.</b><br><a href="mailto:kozetadoda@yahoo.com">kozetadoda@yahoo.com</a> <a href="mailto:fabianakeci@gmail.com">fabianakeci@gmail.com</a><br>Adresa: Këshilli i Bashkisë, Njësia Administrative Xhafzotaj kat 3. |
| Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme                      | Opcionet e mundëshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit :<br>Ndryshime në alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.   |

|   |  |
|---|--|
| Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me cështjen që konsultohet.   | Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen Web të bashkisë, ndërfaqa këshilli bashkiak, file - konsultimet publike, projekt vendim "Per paketen Fiskale 2023":  |
| Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet qe do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit | <p>Dërgimi i sugjerimeve të komunitetit do të jetë i mundur deri në 15 <b>dhjetor 2022</b>, nëpërmjet adresave të emailit: <a href="mailto:kozetedoda@yahoo.com">kozetedoda@yahoo.com</a> <a href="mailto:fabianakeci@gmail.com">fabianakeci@gmail.com</a></p> <p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërrja publike e kësaj Përbledhje;</li> <li>Dërgimi i kësaj Përbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomise dhe Financës, taksave dhe tarifave dhe çdo këshilltari të bashkisë;</li> <li>Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës, taksave dhe tarifave (<b>mbledhja e komisionit është e hapur për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar</b>) të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë;</li> <li>Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në Paketen Fiskale. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të Paketes Fiskale ;</li> <li>Diskutimi dhe miratimi i aktit në <b>seancën e hapur</b> të Mbledhjes së Këshillit;</li> <li><b>Informimi i komunitetit</b>, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre;</li> <li><b>Publikimi</b> i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit;</li> <li><b>Njoftimi</b> i administratës për aktin e miratuar;</li> <li><b>Monitorimi</b> i zbatimit të tij.</li> </ol> |
| Data e publikimit   | <b>06.12.2022</b>  |